

1. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

DATA	R/REPO njëjavore		R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore	Blerje me të drejta të plota
	Me shumë të shpallur	Me çmim fiks			
02.10.2008	5,300.00				
09.10.2008	2,700.00				
10.10.2008			4,000.00		
14.10.2008			3,660.00		
16.10.2008	4,560.00				
22.10.2008			2,000.00		
23.10.2008	7,988.00				
30.10.2008	8,380.00				
06.11.2008	11,500.00			3,500.00	
11.11.2008					1,900.00
13.11.2008		11,090.00		3,000.00	
20.11.2008		12,180.00			
27.11.2008		10,570.00			1,100.00
02.12.2008					2,000.00
04.12.2008		9,900.00			3,000.00
11.12.2008		13,490.00			3,000.00
18.12.2008		18,650.00			
26.12.2008		17,190.00			

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit në përgjigje të kërkesës për të në sistemin bankar.

Për të injektuar likuiditetin, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor* mesatarisht 9.33 miliardë lekë në javë.

Për të normalizuar sjelljen e bankave ndaj normave të interesit të ofruara për marrjen e likuiditetit nga Banka e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë ndryshoi formën e ankandit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor në ankande me çmim fiks si dhe përdori marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me maturim më të gjatë se një javë dhe instrumentet e përheshme. Konkretisht, u injektuan mesatarisht 3.2 miliardë lekë në tre raste përdorimi të *marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëmujor* dhe 3.25 miliardë lekë në dy raste përdorimi të *marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim tremujor*.

Banka e Shqipërisë bleu me të drejta të plota bono thesari nga bankat e nivelit të dytë në nivelin 11 miliardë lekë (vlerë nominale).


1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008, për investimin e likuiditeteve të lira të krijuara në bazë ditore, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 2.78 miliardë lekë, në krahasim me 5.07 miliardë lekë në tremujorin e kaluar.

Instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal me rreth 0.17 miliardë lekë në 1 rast përdorimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblodhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2008.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2008.



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në tremujorin e katërt të vitit 2008 Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor. Rrjedhimisht nuk ka pasur veprime me bankat e nivelit të dytë.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe janë kryer veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i qeverisë shqiptare për shlyerjen e

kësteve të borxhit të jashtëm. Shitjet e kryera gjatë tremujorit të katërt llogariten në 1,391.57 milionë lekë.

Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave gjatë kësaj periudhe ishte 5,002.52 milionë lekë. Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 37.81 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)).

Institucioni financiar	Blerje të valutës	Shitje të valutës
MINISTRIA E FINANCEVE	5,002.52	1,391.57
TE TJERA (IDA, IBRD)	37.81	-